



Datë: 19.12.2025

Numër Protokolli: 8081/2025

A.nr.1499/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1499/2025, të datës 29.07.2025, të parashtruar nga ankuesi A.Z, kundër organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1499/2025, e datës 29.07.2025, e parashtruar nga ankuesi A.Z, **Anulohet** në tërësi konkursi me numër reference: RN00017335, Grupi Ligjor, pozita e punës Inspektor për Marrëdhënie të Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës, Inspektorati Qendror i Punës.

II. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendim, të ndërmerr veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç përcaktohet në pikën I të dispozitivit.

III.Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1499/2025, të datës 29.07.2025, e parashtruar nga ankuesi A.Z, lidhur me konkursin me numër reference: RN00017336, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës, Inspektorati Qendror i Punës.

IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil A.Z (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 29.07.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017335, Grupi Ligjor, pozita e punës Inspektor për Marrëdhënie të Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës dhe konkursin me Nr. Reference: RN00017336, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës, të shpallura nga Inspektorja ti Qendror i Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa, ky i fundit, ka përcjellë shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorit administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5133/2025, të datës 29.07.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Njoftimin e datës 05.07.2025 për rezultatet përfundimtare sipas konkursit me Nr. Reference RN00017336; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.08.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 01.09.2025; Konkursin RN00017336 për Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë; Vendimin me numër protokolli 1104 të datës 29.05.2025 për themelimin e komisionit të pranimit; Akt Emërimet/vendimet për anëtarët e komisionit të pranimit; Listën aplikantëve sipas konkursi RN00017336; Njoftimin e datës 23.05.2025 për verifikim paraprak për konkursin RN00017336; Aplikacionin e datës 23.03.2025 të kandidatës F.P me dokumentacionin nga faqe 1-18; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë datës 02.07.2025; Aplikacionin e ankuesit i datës 14.04.2025 me dokumentacionet nga faqe 1-17; Konkursin RN00017335 për pozitën Inspektor për Marrëdhënie të Punës në Rajonin e Pejës; Listën e aplikantëve për konkursin RN00017335; Njoftimin e datës 11.07.2025 për rezultatet përfundimtare sipas Konkursit RN00017335; Aplikacionin e kandidat B.S me dokumentacionet nga faqe 1-14; Aplikacionin e kandidat F.AS të datës 17.04.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-26; Aplikacionin e kandidat B.D të datës 05.04.2025 me dokumentacionet nga faqe 1-11; Aplikacionin e kandidate D.K të datës 24.03.2025 me dokumentacionet nga faqe 1-8; Aplikacionin e kandidat F.H të datës 20.04.2025 me dokumentacionet nga faqe 1-26; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë datës 26.07.2025; Aplikacionin e ankuesit i datës 14.04.2025 me dokumentacionet nga faqe 1-17.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit lidhur me konkursin me numër të referencës: RN00017335, pozita e punës Inspektor për Marrëdhënie të Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës, **është e bazuar, sepse:**

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Inspektorati Qendror i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00017335, Grupi Ligjor, pozita e punës Inspektor për Marrëdhënies të Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës numri i kërkuar gjashtë (6), klasa profesional 1, më afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.
- Inspektorati Qendror i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00017336, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës numri i kërkuar një (1), klasa profesional 1, të gjithë ma afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.
- Ankuesi ka aplikuar në të dy konkurset si me sipër dhe se i njëjti rezulton se ka kaluar fazën e verifikimit paraprak për të marr pjesë në fazën e vlerësimit profesional, mirëpo sipas thënieve në ankesë i njëjti nuk ishte ftuar për fazat e vlerësimit.
- Më datë 11.07.2025, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës, ka publikuar rezultatet përfundimtare lidhur me konkursin me Nr. Ref: RN00017335, sipas të cilit njoftim rezulton së vetëm pesë (5) kandidatë kanë arritur mbi 70 pikë, ashtu që të njëjtit janë shpallur edhe kandidat fitues dhe atë: F.P me 81 pikë, D.K me 79.2 pikë, L.S me 72.2 pikë, F.H me 71.8 pikë, B.S me 71.8 pikë dhe A.Xh me 70.6 pikë.
- Më datë 05.07.2025, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare lidhur me konkursin me nr. ref: RN00017336, sipas të cilit njoftim rezulton se si kandidat të suksesshëm janë shpallur: B.S me 88.4 pikë, F.A me 87 pikë, B.D me 83 pikë, D.K me 81 pikë dhe F.H me 77.6 pikë.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është ftuar në testin me shkrim dhe intervistë me gojë për këtë konkurs dhe kërkon që të anulohen konkurset e kontestuar.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimi më Nr.Ref: RN00017335, rrjedhimisht në këtë kontekst, Kolegji ka konstatuar së proceduara e kundërshtuar është shpallur sipas autorizimit të ushtrueses së detyrës të Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, autorizim ku i materializuar përmes Vendimit nr.prot:612 të datës 21.03.2025, ndërsa, Komisioni i Pranimi për vlerësim profesional të kandidateve në procedurën përkatëse është themeluar sipas Vendimit nr.prot:1104 të datës 29.05.2025, të Ud të Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës.

Rrjedhimisht, duke qenë se pozita e Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës ushtrohet më ushtrues të detyrës, Kolegji ka trajtuar çështjen e kompetencës ligjore të ushtruesit të detyrës Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës vetëm në vështrim të legjislacionit në fuqi gjegjësisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik (i aplikueshëm nga data 26.09.2023) si dhe referuar kohës së nxjerrjes së aktit të kontestuar më ankesë, ashtu që, në këtë kontekst iu referua nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin përcaktohet se : *1 Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm..”.*

Nisur nga ky përcaktim ligjor, Kolegji konstaton se në rast se një pozitë drejtuese është e lirë, zyrtari më i lart administrativ i institucionit/titullari cakton ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë, ashtu që si ushtrues detyre mund të caktohet vetëm zyrtarja/i më i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. Në fakt, më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë të gjitha institucionet publike kanë qenë të obliguara që emërimin e ushtruesit të detyrës për pozitën përkatëse të lirë ta bëjnë në pajtim të plotë më kërkesat ligjore të parapara më këtë ligj, ndërsa, sipas provave të lëndës vërtetohet se pozita e Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës ka qenë e lirë nga muaji mars 2025, ashtu që, ministri i MFPT më Vendimin Nr.11/2025 të datës 06.03.2025 (nr. protokolli 701/2025, të datës 06.03.2025), ka emëruar zyrtarin R.P, si ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, emërimi ky që është shpallur i paligjshëm nga Këshilli me Vendimin A.nr.423/2025, të datës 22.04.2025, mbi arsyetimin se R.P mbante pozitën e Zyrtarit Shpenzues dhe të Pasurisë, dhe mbi këtë bazë nuk ishte respektuar kategoria pasuese.

Andaj, referuar konstatimit si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin së autorizimi për shpalljen e procedurës së kontestuar dhe themelimi i Komisionit të Pranimit konsiderohen si veprime administrative të ndërmarra në mungesë të kompetencës ligjore të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës dhe si të tilla në tërësinë e saj cenojnë ligjshmërinë e procedurës së kontestuar, kështu që, mbi këto rrethana ligjore rrjedhë së procedura më nr.ref: RN00017335 është procedurë e paligjshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *1.Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji.*

Thënë si më lartë, Këshilli bazuar në autorizimeve ligjore sipas nenit 53, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme dhe nenit 18 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, aprovoj ankesën si të bazuar dhe anuloi në tërësi procedurën e pranimit më numër të referencës RN00017335, pozita e punës Inspektor për Marrëdhënie

të Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës, duke obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të që të ndërmerr veprime për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën I të dispozitivit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se objekti i ankesës së ankuesit lidhur me konkursin me Nr. Ref: RN00017336, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës, është bërë i pamundur, **sepse**:

Duke qenë së kandidatja V.A, si kandidat aplikuese në procedurën e rekrutimit me Nr. Reference: RN00017336, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (A.nr.1499/2025, të datës 29.07.2025) duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, ky i fundit, më Vendimin me numër A.nr.1355/2025, të datës 02.10.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimi më Nr. Ref: RN00017336.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1499/2025, të datës 29.07.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimi për të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1355/2025, të datës 02.10.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi këtë procedurë, si një nga qëllimet e palës ankuese në petitum të ankesës, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.1499/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1499/2025, të datës 29.07.2025, lidhur me konkursin me Nr. Ref: RN00017336.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1499/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.Z;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së